

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 416, datë 7.4.2011 “PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi i dispozitave ligjore lidhur me rregullat për sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbështetjen e prodhimit bujqësor, mbrojtjen e interesave të fermerit si dhe të grupeve të interesit.

Projektligji synon të arrijë disa objektiva:

- Garantim të materialit mbjellës dhe shumëzues, të vendosur në treg, regjistrimin e varieteteve të reja në katalogun kombëtar si dhe procedurat për certifikim zyrtar.
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si edhe për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve gjatë fazës së prodhimit deri në certifikim.
- Saktësimi i procedurave lidhur me regjistrimin e varieteteve të reja në mbështetje të një bujqësie të qëndrueshme.
- Futja e konceptit “operator profesionist” në përputhje me legjislacionin e BE-së si për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor dhe të atij të shëndetit të bimëve koncept i cili ka zëvendësuar termin “furnizues”.
- Të mbështesë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të përdorur në bujqësinë organike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar për t'u miratuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024 (PPAP), për vitin 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Njohja dhe evidentimi i çdo hallke të zinxhirit ushqimor është i një rëndësie të veçantë për garantimin e shëndetit publik dhe mbrojtjen e interesit të konsumatorit në përgjithësi.

Nëpërmjet miratimit të këtij projektligji sigurohet baza ligjore për hartimin e disa akteve nënligjore në zbatim të tij, duke bërë të mundur zgjidhjen e problematikave të hasura me ligjin ekzistues.

Gjatë praktikës së zbatimit të ligjit janë konstatuar se ligji ka nevojë për disa rregullime ligjore që lidhen me aktet nënligjore, ku pjesa më e madhe e tyre janë Vendime të Këshillit të Ministrave, edhe pse ato janë të natyrës teknike si dhe nuk impaktojnë institucione të ndryshme nga MBZHR.

Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është grupi më i rëndësishëm i inputeve bujqësore dhe me një shumëllojshmëri varietetesh, kultivarësh dhe biotipesh, me ndikim të drejtpërdrejtë në prodhimtarinë e cilësinë e prodhimit. Ky projektligj prek mbi 40% të përmbajtjes të ligjit Nr. 10416 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar dhe, për këtë arsye, paraqitet si amendim i ligjit ekzistues.

Përparësitë dhe efektet e pritshme janë, si më poshtë vijon:

1. Ky projektligj, ka përmirësuar strukturat, procedurën dhe kërkesat për regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në katalogun kombëtar:
 - është përcaktuar se aplikimi për regjistrimin kryhet në sistemin *on-line* në platformën ndërqeveritare e-albania, duke saktësuar dhe dokumentacionin e kërkuar;
 - janë cituar më qartë dhe thjeshtë kushtet që duhet të plotësojë një varietet për t'u regjistruar në Katalogun Kombëtar;
 - ka përcaktuar rolin dhe funksionin e Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve (KRV), si organ kolegjal teknik, i përhershëm dhe vendimmarrës, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të varieteteve;
 - rregullon ofrimin e informacionit për grupet e interesit, institucionet zyrtare të kontrollit si dhe për fermerët apo palë të tjera të interesuara, nëpërmjet publikimit të Katalogut Kombëtar në faqen zyrtare të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Ministrisë si dhe përditësimin sa herë që pëson ndryshime;

- përcakton më qartë procedurën që ndiqet për regjistrimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në katalogun kombëtar;
 - në procedurën e regjistrimit, ESHFF kryen vlerësimin ndërsa Komisioni i Regjistrimit të Varietetit (KRV), sipas vlerësimit të dërguar nga ESHFF, vendos për regjistrimin ose jo të varietetit në Katalogun Kombëtar;
 - është thjeshtuar çregjistrimi dhe rinovimi regjistrimit në kërkesa dhe procedurë ku vendimi meret direkt nga Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV).
2. Përcakton strukturat përkatëse dhe detyrat e secilës prej tyre me mirëfunksionimin e kontrollit dhe monitorimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që nga prodhimi, tregtimi, si dhe të analizimit të tyre:
- Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
 - Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve, për certifikimin e materialit të prodhuar në vend;
 - ESHFF, krahas detyrave të parashikuara në ligjin aktual, kryen edhe analizimin për mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosura në treg, të sjella nga Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg si dhe subjektet private;
3. Përcakton se Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor lidhur me plotësimin e kërkesave të përcaktuara për tregtim në këtë ligj, kryhet në bazë të planit vjetor të kontrolleve zyrtare dhe marrjes së mostrave me bazë risku, të miratuar me urdhër Ministri.
4. Përcakton më qartë institucionin dhe rastet kur mund të lëshohet autorizim i veçantë me citimin: “Importi për raste emergjente i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhet me autorizim të veçantë të ministrit”.
5. Meqenëse prodhimi dhe tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhet pa licencim, janë vendosur dy kritere që duhet të plotësohen nga personat juridik ose fizik, gjatë ushtrimit të këtyre aktiviteteve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me lëgjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 27 nene.

Neni 1 përcakton se kudo në ligj, emërtimet “furnizues”, “fillestar” dhe “Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRKK)” zëvendësohen respektivisht me emërtimet “operator profesionist”, “para-bazë” dhe “Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV)”, ndërsa “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ose AKU” zëvendësohen me “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, me përjashtim të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 11 dhe pikës 1 të nenit 13. Emërtesat e institucioneve ESHFF, AKU, kudo në këtë ligj janë zëvendësuar me termin “ institucione përgjegjëse” sipas fushës së përgjegjësisë. Gjithashtu në këtë projektligj është përcaktuar institucioni përgjës për kontrollin zyrtar lidhur me shëndetin e bimëve gjatë fazës së prodhimit deri në certifikim që nënkupton aktualisht AKVMB.

Neni 2 përcakton riformulimin e 2 termave të nenit 3, konkretisht, “inspektim” dhe “inspektor” si dhe shtimin e termit “Material mbjellës i certifikuar jo përfundimisht”.

Neni 3 përcakton riformulimin e shkronjës “a” të pikës 7 të nenit 4: “Varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar, me përjashtim të neneve 6 dhe 10 të këtij ligji”, duke përcaktuar rastet përjashtimore.

Neni 4 përcakton shfuqizimin e pikës 2 të nenit 5, për arsye se kërksat për tregtimin e materialit mbjallës dhe shumëzues bimor janë të përcaktuara shprehimisht në pikën 1 të këtij neni dhe nuk ka nevojë për miratimin e kërkesave të tjera me akt nënligjor.

Neni 5 përcakton se në nenet ku fjalët e cituara në ligjin aktual “...përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit” zëvendësohen me fjalët “...miratohen me udhëzim Ministri”. Kjo bëhet me argumentimin se janë akte më natyrë teknike të cilat përgatiten nga MBZHR si dhe nuk impaktojnë institucione të ndryshme nga MBZHR. Ky argument sqaron se në rast ndryshimesh të referencave ligjore të jetë i mundur përditësimi në një kohë sa më

të shkurtër me qëllim për të mos krijuar pengesa mbi të gjithë aktivitetin që parashikohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

Neni 6 përcakton riformulimin e pikës 3 të nenit 10 duke i dhënë një kuptim më të qartë; “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, ESHFF-ja lejon tregtimin nëse rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është i regjistruar”.

Neni 7 parashikon disa ndryshime të nenit 11:

“Në pikën 2 bëhen ndryshimet:

“a) në shkronjën “b” shprehja “AKU-së” zëvendësohet me shprehjen “Institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve”.

“b) Në shkronjat “dh” dhe “e”, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “për certifikim”.

1. Pika 5 riformulohet si vijon: “5. Cdo person juridik ose fizik që kërkon të ushtrojë një veprimtari së prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor , paraqet pranë ESHFF-së dokumentacionin, si vijon:

a) Diplomë bachelor ose master të drejtuesit Teknik në fushën e agronomisë:

b) Kontratë pune me kohë të plotë të drejtuesit Teknik”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me përmbajtjen si vijon: “9. Çdo 6 muaj furnizuesi kryen rianalizimin për fuqinë mbirëse për materialin mbjellës shumëzues bimor të vendosur në treg”.

Neni 8 përcakton zëvendësimin e shprehjes “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” me “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve”.

Neni 9 përcakton riformulimin e pikës 4 të nenit 16 duke hequr miratimin e formës dhe përmbajtjes të certifikatës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor jo përfundimtsht të certifikuar dhe duke kaluar miratimin e këtij akti nënligjor me udhëzim të ministrit.

Neni 10 përcakton riformulimin e pikës 1 të nenit 23 për personat që duan të ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin pranë Institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg.

Neni 11 përcakton riformulimin e pikës 4 të nenit 24 duke përcaktuar se indpektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhet në bazë të planit vjetor të kontrolleve zyrtare dhe marrjes së mostrave me bazë risku miratuar nga ministri.

Neni 12 përcakton riformulimin e pikës 1 të nenit 26 duke përcaktuar se importi për raste emergjente i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhet me autorizim të ministrit.

Neni 13 përcakton ndryshime në nenin 29. Konkretisht heqjen e fjalëve “...të cilat i boton në buletin e saj zyrtar” dhe riformulimin e pikës 3 për publikimin e katalogut kombëtar dhe përditësimin e tij në faqet zyrtare të ESHFF dhe MBZHR.

Neni 14 përcakton riformulimin e nenit 30 për kërkesat e regjistrimit të një varieteti.

Neni 15 parashikon disa ndryshime në nenin 31 duke riformuluar pikën 1 dhe 2, lidhur me kushtet për regjistrimin e varietetit dhe OMGJ në Katalogun Kombëtar.

Neni 16 përcakton ndryshimin e fjalisë së parë të pikës 2 të nenit 33, konkretisht, në qoftë se kërkuesi deklaron në kërkesë se varieteti është testuar për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet dhe është miratuar si varietet i ri në Republikën e Shqipërisë ose në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian a në një nga shtetet nënshkruese të konventës së UPOV-it, testimi mundet të mos kryhet me kusht që furnizuesi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkon të testojë të paraqesë në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dokumentacion zyrtar, nëpërmjet të cilit vërtetohen karakteristikat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor (Skedën), dhe provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS)”.

Neni 17 riformulon nenin 35 lidhur me regjistrimin e varietetit në Katalogun kombëtar.

Neni 18 citon disa ndryshime në nenin 36, ku zëvendëson akronimin “KVVRKK” me akronimin “ESHFF” për arsye se organi kompetent për vlerësimin për regjistrim ose cregjistrim është ESHFF ndërsa KVVRKK është përgjegjës për vendimmarrje dhe riformulimin e pikës 2 sipas së cilës vendimi për çrregjistrimin merret nga Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV). Gjithashtu parashikon shfuqizimin e pikës 3 për arsye se pikat 1 dhe 2 të këtij neni janë shteruese për përmbushjen e këtij detyrimi.

Neni 19 përcakton riformulimin e nenit 37 lidhur me rinovimin e regjistrimit të një varieteti.

Neni 20 përcakton se në pikën 1, të nenit 39, fjala “të listuar” zëvendësohet me fjalën “të regjistruar”.

Neni 21 përcakton riformulimin e nenit 40 lidhur me Komisionin e Regjistrimit të Varieteteve.

Neni 22 përcakton disa ndryshime në pikën 1 të nenit 41, konkretisht riformulimin e shkronjave “a” dhe “e” si dhe shtimin e shkronjës “ë” me këtë përmbajtje: “ë) të publikojë KK në faqen zyrtare”.

Neni 23 përcakton disa ndryshime në nenin 42, konkretisht: “1. Titulli i nenit riformulohet: “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar”;

2. Pika 1 riformulohet si vijon: “1. Detyrat e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë:”
3. Shkronja “a”, e pikës 1 riformulohet si vijon: “a) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai magazinohet e tregtohet”;
4. Në shkronjën “c”, të pikës 1, hiqet fjala “të importuar”.

Neni 24 përcakton riformulimin e nenit 43, konkretisht:

“Neni 43.

Veprimtaritë e ndaluara

1. Ndalohet prodhimi dhe vendosja në treg i:
 - a) materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të paregjistruar në katalogun kombëtar, me përjashtim të rasteve që parashikohet ndryshe në këtë ligj;
 - b) kryerjes së veprimtarive të prodhimit dhe të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 11 si dhe me pikën 1 të nenit 23, të këtij ligji.
2. Ndalohet përkohësisht tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili nuk është ambalazhuar dhe etiketuar sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij”..

Neni 25 përcakton riformulimin e pikës 2 të nenit 44 se laboratorit i referencës kryen analizat e mostrave, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimi të treguesve cilësorë për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, sipas metodikave të Shoqatës Ndërkombëtare të Testimit të Farëve (ISTA).

Neni 26 përcakton riformulimin e pikës 1 të nenit 55 se të drejtën e vendosjes së masës administrative, të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Institucionit përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor në treg dhe Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve.

Nenin 27 përcakton dispozitat kalimtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes

së Bimëve, Drejtoria e Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehërave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë të Informacionit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi ndërinstytucional i punës i miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 58, datë 31.1.2024 Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10416 datë 7.4.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”. Në përbërje të grupit të punës, kanë qenë anëtarë nga Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehërave, në ministri dhe Sektori i Farërave Fidanëve dhe Produkteve Plehëruese në rolin e sekretarisë teknike dhe njëkohësisht sektori që ka në fushën e tij të përgjegjësisë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe përfaqësues nga ESHFF, AKU, AKVMB, dhe QTTB.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTËR

ANILA DENAJ